



Prishtinë, 29 dhjetor 2010

Kodi i ZRRE-së: V\_332\_2010

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,**

Bazuar në:

- Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) të dhëna në dispozitat e Nenit 14 dhe 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr. 03/L-185;
- Kërkesën zyrtare për aprovimin e Kodit për Stacionet Gjeneruese të Energjisë me Erë të dorëzuar nga Operatori i Sistemi të Transmisionit dhe Tregut të Kosovës (KOSTT Sh.a) më datë 24 dhjetor 2010;

**në seancën e mbajtur me datë 29 dhjetor 2010, nxori këtë:**

## VENDIM

**I. Aprovohet** Kodi për Stacionet Gjeneruese të Energjisë me Erë.

### Arsyetim

- KOSTT-i ka përgatitur draftin e Kodit për Stacionet Gjeneruese të Energjisë me Erë të cilën e ka dërguar në Zyrën e Rregullatorit për Energji (ZRRE) për shqyrtim dhe aprovim.
  - Zyra e Rregullatorit për Energji ka analizuar, komentuar dhe vlerësuar Kodin për Stacionet Gjeneruese të Energjisë me Erë, dhe ka dërguar në KOSTT komentet e veta në formë të shkruar. KOSTT-i është përgjigjur në komentet e ZRRE-së dhe i ka përfshirë apo sqaruar ato në dokument, duke krijuar draftin final të Kodit për Stacionet Gjeneruese të Energjisë me Erë.
  - Me datë 24.12.2010, KOSTT ka dërguar në ZRRE kërkesën zyrtare për aprovimin e Kodit për Stacionet Gjeneruese të Energjisë me Erë.
- II.** Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes së versioneve, atëherë do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.
- III.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund t'i drejtohet Gjykatës Kompetente, brenda katërbëdhjetë (14) ditëve nga data e pranimin të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

**Bordi i ZRRE-së**

---

Dr. Ali Hamiti, kryesues

---

Përparim Kabashi, anëtar

---

Theranda Beqiri, anëtare

---

Blerim Koci, anëtar